



PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2023
ME ZGJEDHJE – SESIONI I
SKEMA E VLERËSIMIT

LËNDA: QYTETARI DHE PSIKOLOGJI

Varianti B

Pyetjet me alternativa

| | | | | | | | | | | |
|-------------------|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|
| Pyetja | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| Përgjigja e saktë | B | A | A | C | B | A | D | B | A | C |
| Pyetja | 19 | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 | 27 | 28 |
| Përgjigja e saktë | A | D | B | D | D | A | C | B | A | D |

Pyetjet me zhvillim

Shënim: Për pyetjet me zhvillim, nxënësi fiton pikët, edhe nëse jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta.

Qytetari

Pyetja 11 3 pikë
Model përgjigje

- Ka paguar për sendin e marrë.
- Bën blerje për nevoja vetjake dhe jo për qëllime tregtare.
- Ka marrë shërbimin te ai që ligji e njuh si tregtar.

3 pikë nëse përcakton tre kushtet;
2 pikë nëse përcakton dy kushtet;
1 pikë nëse përcakton një kusht;
0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12 2 pikë
Model përgjigje

- Çdo individ ka përgjegjësi të ruaj dhe përmirësoje shëndetin vetjak duke praktikuar sjellje të shëndetshme të cilat lidhen me: ushqyerjen e përshtatshme; kryerjen e aktivitetit fizik; shmangien e përdorimit të duhanit, alkoolit, substancave të dëmshme për shëndetin.
- Çdo individ ka për detyrë të respektojë të drejtën e tjetrit që lidhet me ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit, parandalimin e sëmundjeve si dhe riaftësimin pas tyre.
- Shmangien e sjelljeve të cilat konsiderohen të rrezikshme për shëndetin e të tjerëve.
- Përdorimin e kujdesshëm të hapësirave publike për të mos dëmtuar të tjerët.
- Informimi i individëve të tjerë për parandalimin e sëmundjeve që kërcënojnë shëndetin.

- Përfshirja e individit në programet e vaksinimit për të parandaluar sëmundjet ngjitëse.
- Etj.

2 pikë nëse shpjegon dy detyra;

1 pikë nëse shpjegon një detyrë;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13

2 pikë

Model përgjigje

- Organizimi i debateve i ndihmon të njohin më mirë të drejtat e tyre dhe të respektojnë të drejtat e të tjerëve.
- Përmes organizimit të debateve nxënësit mësojnë për qeverisjen demokratike, llogaridhënien dhe përfshirjen e votuesve në proceset vendimmarrëse.
- Debati inkurajon nxënësit të mësojnë të drejtën për të shprehur lirisht qëndrimin e tyre duke argumentuar pozicionin që mbështesin.
- Në rregullat e debatit mësojnë të respektojnë njëri-tjetrin, në radhën e komunikimit dhe parashtrimin e argumenteve me etikë, pavarësisht pikëpamjeve të ndryshme.
- Debati mëson nxënësit se palët në debat janë të barabarta dhe vlerësohen mbi parime e kritere të përcaktuara.
- Organizimi i debateve ndihmon në parashtrimin (artikulimin) e kërkesave dhe çështjeve që kanë nevojë për të ndryshuar, përmirësuar gjendjen aktuale, duke u bërë promotor të zhvillimit, zgjerimit të të drejtave.
- Nxënësit aftësohen të mendojnë në mënyrë kritike dhe krijuese duke analizuar faktet dhe hulumtuar në burime kërkimore të sigurta, për t'u orientuar drejtë e në përputhje me ligjin në shoqëri.
- Në debat kultivohet edukimi i konkurrencës së ndershme. Transparenca e rezultateve që nxënësve u jepet në formën e pikëve i vetëdijëson ata për humbjet dhe fitoret.
- Debatet edukojnë me parimet e respektit, paqes dhe marrëveshjeve përmes diskutimeve.
- Në debat nxënësit zgjedhin liderin/en e ekipit duke ndihmuar të kuptojnë procesin e zgjedhjes, si mënyrë përfaqësimi dhe ushtrimi i të drejtës në demokraci.
- Përmes debateve nxënësit mësojnë aftësi sociale dhe sillen me përgjegjshmëri ndaj ekipit tjetër, jurisë etj.
- Etj.

2 pikë nëse analizon dy aspekte;

1 pikë nëse analizon një aspekt;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 14

3 pikë

Model përgjigje

- 1) Të drejta civile dhe politike; kategoria/brezi i parë
- 2) Të drejta për mjedisin; kategoria/brezi tretë
- 3) Të drejta sociale; kategoria/brezi dytë

3 pikë nëse dallon tre kategori;

2 pikë nëse dallon dy kategori;

1 pikë nëse dallon një kategori;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 15

2 pikë

Model përgjigje

- Nxënësit marrin njohuri sistematike, duke përvetësuar dije teorike nga mësimi i disiplinave të caktuara të lëndëve në shkencat shoqërore (psikologji, histori, etj.) dhe lëndëve në shkencat natyrore (kimi, fizike, etj.).
- Socializimi si një proces ndërveprimi ndërmjet njëri-tjetrit për të zhvilluar aftësi sociale të domosdoshme për rregullat në shoqëri.
- Transmetimi i normave kulturore duke siguruar vazhdimësinë kulturore nga njëri brez në brezin tjetër.
- Pranimi i ndryshimeve dhe toleranca. Shkolla i ndihmon nxënësit të pranojnë njëri-tjetrin përtej diferencave dhe integrimin e tyre përmes aktiviteteve të ndryshme.
- Zbulimi dhe zhvillimi i talenteve përmes organizimeve të aktiviteteve të ndryshme.

- Formimi i shprehive të nevojshme të cilat lidhen me njohjen dhe zbatimin e rregullave.
- Përgatitjen e nxënësve për tregun e punës përmes orientimit ndaj kërkesave të tregut të punës.
- Ndhmon në formimin e personalitetit të individit, duke zbuluar dhe kultivuar tiparet e tyre.
- Ofron mbështetje për të përballuar sfida të së ardhmes përgjatë proceseve edukuese, këshillimit të karrierës, shërbimit psiko-social, etj.
- Zhvillon të menduarin kritik, krijues, reflektimin dhe gjykimin e situatave problemore.

2 pikë nëse shpjegon dy funksione;

1 pikë nëse shpjegon një funksion;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 16

2 pikë

Model përgjigje

- Të kalojnë rrugën kur semafori u jep përparësi.
- Në vendet ku nuk ka semafor, të kalojnë në vijat e bardha.
- Të respektojnë sinjalet që rregullojnë qarkullimin e këmbësorëve.
- Të përdorin nënkalimet dhe mbikalimet.
- Të respektojnë me përparësi sinjalet e policit të trafikut.
- Të kontrollojnë rrugën nëse është e lirë.
- Të kontrollojnë distancën dhe shpejtësinë e mjetit, përpara se të marrë vendimin për të kaluar.
- Të presin sinjalin nga drejtuesi i mjetit për të kaluar rrugën në mënyrë të sigurt.
- Etj.

2 pikë nëse përcakton dy rregulla;

1 pikë nëse përcakton një rregull;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 17

3 pikë

Model përgjigje

- Përhapja e lirë dhe e pavarur e ideve përbën një element të rëndësishëm të një shoqërie demokratike.
- Orientohemi më drejtë si qytetar aktiv dhe kritik në proceset vendimmarrëse politike.
- Kemi mundësi për të marrë dhe për të dhënë informacione të ndryshme. E drejta e informimit dhe përditësimit me situatën në vend dhe atë ndërkombëtare, lidhur me sfera të ndryshme të zhvillimeve, në rrafshin social, kulturor, politik, etj, na ndihmojnë të orientohemi.
- Zhvillojmë vetëdijen sociale për të reaguuar ndaj dukurive të caktuara, që shqetësojnë shoqërinë.
- Fuqizohen qytetarët dhe rritet kontrolli mbi procese të caktuara politike.
- Mundësohet parandalimi i arbitraritetit në politikëbërje, duke qenë se rritet vetëdija qytetare.
- Njohje me kultura të ndryshme, shkëmbim përvojash, traditash, për të zhvilluar tolerancë, pranim ndaj të ndryshmes.
- Etj.

3 pikë nëse vlerëson tre aspekte;

2 pikë nëse vlerëson dy aspekte;

1 pikë nëse vlerëson një aspekt;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 18

3 pikë

Model përgjigje

- Kushte të përshtatshme fizike (ajrosja, lagështia, higjiena, ndriçimi, temperatura, zhurmat, detergjentët, lëndët kimike etj.).
- Masat e sigurisë dhe shëndetit në punë, mbrojtja dhe shpërblimet në rast aksidenti në punë.
- Pagesa e siguracioneve të punonjësve (sigurimet shoqërore për sëmundje, barrëlindje, invaliditeti, pension pleqërie etj.).

- Orari i punës (8 orë, më pak mund të jenë profesione të parashikuara nga ligji).
- Pushimet javore, vjetore dhe ditët e festave, sipas kontratës së punës, bazuar në Kodin e Punës.
- E drejta e pagesës referuar standardit të pragut minimal të përcaktuar në ligj.
- E drejta e pagesës së përshtatshme për punën, për llojin e profesionit dhe kualifikimin, si dhe pagesat shtesë për orët jashtë orarit, në ditët e pushimit, etj.
- Mbrojtja e personalitetit dhe dinjitetit të punonjësve.
- Mbrojtja e veçantë për fëmijët dhe gratë.
- E drejta e raportit mjekësor.
- Etj.

3 pikë nëse përshkruan tri të drejta;

2 pikë nëse përshkruan dy të drejta;

1 pikë nëse përshkruan një të drejtë;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.

Psikologji

Pyetja 29

3 pikë

Model përgjigje

- Ndryshon ndjeshëm perceptimi që kemi për veten dhe botën përreth.
- Të menduarit bëhet i paorganizuar, jo kritik dhe i sipërfaqshëm.
- Mund të perceptojë në mënyrë të shtrembëruar, të shoh dhe dëgjojë gjëra që realisht nuk ekzistojnë.
- Vështirësi në përqendrim.
- Mosnjohja e vetes dhe pamundësia për të dalluar veten nga të tjerët.
- Dobësim i kontrollit të vetes, ndikuar nga përdorimi i alkoolit dhe drogave .
- Nuk mbahet mend çfarë ka ndodhur në këtë gjendje (p.sh vështirë të mbajmë mend ëndrrat).
- Etj.

3 pikë nëse përcakton tri karakteristika;

2 pikë nëse përcakton dy karakteristika;

1 pikë nëse përcakton një karakteristike;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 30

3 pikë

Model përgjigje

- Ndikimi i forcave kontradiktore, herë ndihen të fuqishëm, rezistent, të pagabueshëm, me vetëvlerësim të lartë e herë të tjera krejt e kundërta. Nga njëra anë kërkojnë të jenë të pavarur e nga ana tjetër nuk mund tja dalin të marrin përgjegjësi për këtë dhe kërkojnë kujdes e vëmendje nga prindërit.
- Në marrëdhënie me më të rriturit, prindërit, mësuesit etj., ata trajtohen herë si fëmijë e herë si të rritur që duhet të marrin përgjegjësi. Adoleshentët mendojnë se nuk marrin mbështetjen dhe mirëkuptimin e tyre.
- Kontradiktat për shkak të diferencave moshore me të rriturit, krijojnë konflikte lidhur me pritshmëritë, mënyrën se si mendojnë dhe organizojnë përditshmërinë adoleshentët.
- Presioni i grupeve shoqërore për të orientuar mënyra të caktuara sjelljeje duke krijuar dilema midis sociale dhe individuale.
- Perceptimi i gabuar për veten duke e mbivlerësuar ose nënvlerësuar, bazuar në gjykime jo të drejta. Këto gjykime, perceptime ndikohen nga popullariteti që kanë në grup, roli e mediave sociale, përkrahja apo nëpërkëmbja, etj.
- Sfida e identifikimit të vetes dhe nevoja për t'i dhënë përgjigje: Pyetjeve si kush jam? Çfarë duhet të zgjedh? Kriza e identitetit shoqërohet me konflikte të brendshme, në nevojën për t'u vetëpërcaktuar si një qenie unike dhe shoqërore.
- Ndihen konfuz dhe kaotik në marrjen e vendimeve dhe shpesh kanë reagime impulsive.
- Prireja egocentrike për të qenë të fokusuar shumë të vetja dhe paraqitja e jashtme.
- Etj.

- 3 pikë** nëse shpjegon tre faktorë;
2 pikë nëse shpjegon dy faktorë;
1 pikë nëse shpjegon një faktor;
0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 31 **2 pikë**
Model përgjigje

- Aftësia për të njohur dhe kontrolluar emocionet e veta, për të pasur reagime dhe qëndrime të matura, jo impulsive;
- Aftësia për të dalluar dhe monitoruar emocionet e të tjerëve;
- Zotësia për t'i vënë këto aftësi në shërbim të qëllimeve, zgjidhjes së problemeve, marrjes së vendimeve dhe rregullimit të marrëdhënieve me të tjerët.
- Rëndësia e krijimit të lidhjeve të forta me njerëzit dhe motivimi në funksion të kultivimit të aftësive sociale dhe mbarëvajtjes së punës.
- Aftësia për të njohur emocionet e dikujt dhe po aq aftësia për të nxitur emocione, për të evidentuar pikat e forta dhe të dobëta, motivimet dhe për të kuptuar se si ato ndikojnë në mendimet dhe sjelljet e dikujt.
- Gjetja e mënyrave produktive për të menaxhuar punën me kolegë të ndryshëm duke respektuar aspektet diferencuese dhe përbashkuese lidhur me qëllimin e përbashkët të punës.
- Menaxhimi i marrëdhënieve që lidhet me aftësinë ndërpersonale. Ky aspekt lidhet me aftësinë për të krijuar besim, respekt ndërmjet kolegëve.
- Empatia me të tjerët është e rëndësishme për harmoninë e ekipit. Njohja dhe përgjigjja ndaj nevojave emocionale të njerëzve krijon një kulturë pune më produktive.

- 2 pikë** nëse analizon dy karakteristika;
1 pikë nëse analizon një karakteristikë.
0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 32 **3 pikë**
Model përgjigje

- Menaxhimi i situatës paraprakisht, për shembull nëse duhet të realizoni një detyrë mund të filloni përgatitjet më herët. Në këtë mënyrë kemi më shumë kohë për të reaguar ndaj një faktori stresues (strategjia e fokusuar te problemi).
- Largimi i vëmendjes nga një aspekt stresues, si një çlirim i përkohshëm, për të zbutur stresin (strategjia e orientuar nga mbrojtja).
- Mësimi i disa teknikave që të ndihmojnë për situata specifike, në mënyrë që të menaxhohet më mirë frika, ankthi etj., duke kontribuar në reduktimin e stresit (strategjia e fokusuar te emocioni).
- Përdorimi i teknikës së relaksimit të muskujve, duke shtrënguar dhe liruar grupe të caktuara muskujsh.
- Ndërmarrja e hapave konkretë për të përballuar një situatë stresante si:
- dallimi stresorit;
- zgjedhja e veprimeve që pakësojnë stresin, përmes hapave konkret të cilët ndihmojnë në përballimin e situatave stresante.
- kryerja e veprimeve të përcaktuara;
- vlerësimi i suksesit të arritur. (strategjia e orientuar nga detyra).
- Zbatimi i teknikës së frymëmarrjes së thellë duke përdorur diafragmën për të nxitur gjendjen e qetësisë.
- Zbatimi i teknikës së imagjinatës së drejtuar, për të imagjinuar diçka të këndshme që sjell qetësi dhe të shkëput nga aspekti stresues.
- Përdorimi i meditimit si një mënyrë që lehtëson stresin. Për këtë duhet siguruar një vend i qetë, një pozicion i rehatshëm, përqendrimi vëmendjes dhe së fundi reagimi pasiv ndaj asaj që ndodh.

- 3 pikë** nëse shpjegon tri mënyra;
2 pikë nëse shpjegon dy mënyra;
1 pikë nëse shpjegon një mënyrë.
0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 33**3 pikë****Model përgjigje**

- Psikologjia klinike
- Psikologjia e këshillimit
- Psikologjia e edukimit
- Psikologjia shkollore
- Psikologjia organizacionale/industriale
- Psikologjia e shëndetit
- Psikologjia e mjedisit
- Psikologjia e sportit
- Psikologjia juridike
- Etj.

3 pikë nëse rendit tre degëzime;**2 pikë** nëse rendit dy degëzime;**1 pikë** nëse rendit një degëzim;**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.**Pyetja 34****3 pikë****Model përgjigje**

- Ndikimi që ka shoqëria edhe në mënyrë jo të drejtpërdrejtë. Shoqëria ka përcaktuar disa norma të cilat përbashkojnë në mënyrë të përgjithshme qëndrimet, duke përfshirë mendimet, emocionet, sjelljet.
- Roli i familjes, bashkëmoshatarëve, shkollës dhe gjithë agjencive të tjera socializuese ndikon që këto rregulla të zbatohen nga të gjithë duke përcaktuar atë që konsiderohet e pëlqyer dhe duke shmangur sjelljet që konsiderohen jo të përshtatshme.
- Frika nga refuzimi ose ndëshkimi që të tjerët mund të bëjnë ndikon në respektimin e parimeve, normave që shoqëria ka vendosur.
- Mungesa e vetëbesimit, nevoja për të pasur mbështetje në mënyrë të vazhdueshme nga të tjerët për të marrë vendime, ndikon në sjellje konformiste.
- Mungesa e iniciativës për të ndryshuar sjellje dhe pafuqia për të kontrolluar jetën e tyre i bën të ndihen më të sigurt me vendimet që merr grupi.
- Nevoja për të qenë të pranuar dhe për të mos krijuar konflikte me grupin, duke përshtatur sjelljet sipas dëshirës së grupit.
- Dëshira për të ruajtur kohezionin shoqëror duke besuar se i shërbejnë fuqizimit të grupit. Ky qëndrim nuk krijon premisa për të vënë në diskutim çështjet që shumica e shoqërisë ka pranuar.
- Duke menduar se të tjerët kanë të drejtë pasi janë shumicë.
- Ndikimi kulturor ndikon në formimin e tyre dhe vlerat nga zgjedhin të udhëhiqen.
- Nuk janë të vendosur për të përcaktuar se ndaj cilave vlera duhet të udhëhiqen për këtë arsye nuk reagojnë për të ndryshuar diçka.
- Duan t'i qëndrojnë besnik rregullave dhe normave të vendosura nga shoqëria, janë tradicionale dhe nuk e duan ndryshimin.
- Nuk kanë guxim të mjaftueshëm për t'iu kundërvënë të tjerëve.
- Presioni social, ata të cilët deviojnë nga normat nuk pranohen.
- Etj.

3 pikë nëse analizon tri shkaqe;**2 pikë** nëse analizon dy shkaqe;**1 pikë** nëse analizon një shkak;**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 35
Model përgjigje**3 pikë**

Fiziologjik-Ndryshimet fizike të brendshme që ndodhën te Ermali nga frika, pasohet nga çlirimi në gjak i adrenalinës, shpeshtim i rrahjeve të zemrës, djersitja e duarve.

Sjelljes- Ermali u tregoi shokëve për përballjen me personin që e ndiqte duke përdorur teknikat e artit marcial të Aikidos. Ai u demonstroi shokëve teknikat e pozicioneve të trupit që kishte përdorur.

Kognitiv- lidhet me mënyrën e kuptimit dhe interpretimit të situatës:

në këtë rast ndryshimi i rrahjeve të zemrës tregon për emocionin e frikës;

mendon se kursi kishte një ndikim të rëndësishëm në rritjen e forcës, vigjilencës dhe reagimet e koordinuara që kishte mësuar përgjatë seancave, ndaj ndihej krenar.

3 pikë nëse analizon tri komponentë;

2 pikë nëse analizon dy komponentë;

1 pikë nëse analizon një komponent;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **ose** nuk përgjigjet fare.